

**ECO RECYCLING SH.P.K.**

**Pasqyrat Financiare  
për periudhën nga data 20 korrik 2017 (data e krijimit)  
deri më 31 dhjetor 2017**

## Përmbajtja

PASQYRA E POZICIONIT FINANCIAR .....	3
PASQYRA E PERFORMANCËS .....	4
PASQYRA E NDRYSHIMEVE NË KAPITALIN NETO .....	5
PASQYRA E FLUKSIT TË MJETEVE MONETARE .....	6
1 Informacion i Përgjithshëm .....	7
2 Bazat e përgatitjes së pasqyrave financiare .....	7
3 Përmbledhje e politikave kontabël .....	8
4 Mjetet monetare .....	11
5 Llogari të arkëtueshme .....	11
6 Llogari të tjera të arkëtueshme .....	12
7 Inventari .....	12
8 Aktivët afatgjatë materiale .....	12
9 Huamarrjet .....	13
10 Llogari të pagueshme .....	13
11 Detyrime tatimore .....	13
12 Detyrime të tjera afatshkurtra .....	13
13 Kapitali aksionar .....	14
14 Shitjet neto .....	14
15 Materiale të konsumuara .....	14
16 Kosto e punës .....	14
17 Shpenzime të tjera .....	15
18 Shpenzime për interesa .....	15
19 Shpenzimi i tatimit mbi fitimin .....	15
20 Palët e lidhura .....	16
21 Menaxhimi i rrezikut financiar .....	17
22 Angazhime dhe detyrime të kushtëzuara .....	17
23 Ngjarje pas datës së bilancit .....	17


**ECO RECYCLING SH.P.K.**  
**PASQYRA E POZICIONIT FINANCIAR**  
 më 31 dhjetor 2017  
 (të gjitha vlerat janë të shprehura në Lekë)

<u>Aktivitet</u>	<u>Shënime</u>	<u>31 Dhjetor 2017</u>
<b>Aktivitet afatshkurtra</b>		
Mjete monetare dhe të tjera ekuivalente	4	614,835
Llogari të arkëtueshme	5	6,539,446
Llogari të tjera të arkëtueshme	6	19,180,814
Inventari	7	2,168,463
<b>Total i aktiveve afatshkurtra</b>		<b>28,503,559</b>
<b>Aktivitet afatgjata</b>		
Aktive afatgjata materiale	8	100,534,457
<b>Totali i aktiveve afatgjata</b>		<b>100,534,457</b>
<b>Totali i aktiveve</b>		<b>129,038,017</b>
<b>Detyrimet dhe kapitali</b>		
<b>Detyrimet afatshkurtra</b>		
Të pagueshme ndaj furnitorëve	10	38,518,188
Detyrime të tjera afatshkurtra	11	618,447
Detyrime tatimore	12	2,422,195
<b>Totali i detyrimeve afatshkurtra</b>		<b>41,558,830</b>
<b>Detyrimet afatgjata</b>		
Huamarrje afatgjata	9	86,060,000
<b>Totali i detyrimeve afatgjata</b>		<b>86,060,000</b>
<b>Totali i detyrimeve</b>		<b>127,618,830</b>
<b>Kapitali</b>		
Kapitali aksionar	13	1,000,000
Fitimi i vitit		419,187
<b>Totali i kapitalit</b>		<b>1,419,187</b>
<b>Totali i detyrimeve dhe kapitalit</b>		<b>129,038,017</b>

Bilanci Kontabël duhet të lexohet së bashku me shënimet shpjeguese në faqet 7-17, të cilat janë pjesë përbërëse e pasqyrave financiare.

Këto pasqyra financiare janë miratuar nga Drejtimi në datën 23 mars 2017 dhe janë nënshkruar nga:

Vladimir Fezga  
 Administrator




**MB CONSULTING SH.P.K.**  
 Hartues i pasqyrave financiare


**ECO RECYCLING SH.P.K.****PASQYRA E PERFORMANCËS**

për periudhën nga data 20 korrik 2017 (data e krijimit) deri më 31 dhjetor 2017  
(të gjitha vlerat janë të shprehura në Lekë)

	<u>Shënime</u>	<u>Për periudhën nga data 20 korrik 2017 (data e krijimit) deri më 31 dhjetor 2017</u>
Shitjet neto	14	11,431,363
<b>Totali i të ardhurave</b>		<b>11,431,363</b>
Ndryshimi i gjendjeve		2,038,494
Materialet e konsumuara	15	(3,835,255)
Kosto e punës	16	(3,859,029)
Amortizimet	8	(2,320,262)
Shpenzime të tjera	17	(1,308,249)
<b>Totali i shpenzimeve</b>		<b>(9,284,301)</b>
<b>Fitimi nga veprimtaria kryesore</b>		<b>2,147,062</b>
<b>Shpenzimet financiare</b>		
Shpenzime për interesa	18	(1,395,931)
<b>Totali i shpenzimeve financiare</b>		<b>(1,395,931)</b>
<b>Fitimi para tatimit</b>		<b>751,132</b>
Shpenzimi i tatimit mbi fitimin	19	(331,945)
<b>Fitimi neto i vitit financiar</b>		<b>419,187</b>
Të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse për vitin		-
<b>Totali i të ardhurave gjithëpërfshirëse për vitin</b>		<b>419,187</b>

Pasqyra e të Ardhurave dhe Shpenzimeve duhet të lexohet së bashku me shënimet shpjeguese në faqet 7-17, të cilat janë pjesë përbërëse e pasqyrave financiare.

**ECO RECYCLING SH.P.K.****PASQYRA E NDRYSHIMEVE NË KAPITALIN NETO**

për periudhën nga data 20 korrik 2017 (data e krijimit) deri më 31 dhjetor 2017  
(të gjitha vlerat janë të shprehura në Lekë)

	<u>Kapitali aksionar</u>	<u>Fitimet e pashpërndara</u>	<u>Totali</u>
<b>Gjendja më 20 korrik 2017 (data e krijimit)</b>	-	-	-
Emetim i kapitalit aksionar	1,000,000	-	1,000,000
Fitimi (humbja) e vitit	-	419,187	419,187
<b>Gjendja më 31 Dhjetor 2017</b>	<b>1,000,000</b>	<b>419,187</b>	<b>1,419,187</b>

Pasqyra e ndryshimeve në kapital duhet të lexohet së bashku me shënimet shpjeguese në faqet 7-17, të cilat janë pjesë përbërëse e pasqyrave financiare.

**ECO RECYCLING SH.P.K.**

**PASQYRA E FLUKSIT TË MJETEVE MONETARE**

për periudhën nga data 20 korrik 2017 (data e krijimit) deri më 31 dhjetor 2017.  
(të gjitha vlerat janë të shprehura në Lekë)

	<u>Shënime</u>	Për periudhën nga data 20 korrik 2017 (data e krijimit) deri më 31 dhjetor 2017
<b>Fluksi monetar nga veprimtaritë e shfrytëzimit</b>		
Fitimi pas tatimit		419,187
Rregullime për:		
Amortizim dhe zhvlerësim	8	2,320,262
Shpenzimet e tatim fitimit		331,945
Shpenzime për interesa; neto		1,395,931
<b>Fitimi operativ para ndryshimeve ne kapitalin punues</b>		<b>4,467,324</b>
Rënie (ritje) në llogaritë arkëtueshme dhe të tjera	5,6	(25,720,261)
Rënie (ritje) në inventarët	7	(2,168,463)
Rritje (rënie) në llogaritë e pagueshme dhe te tjera	10,11,12	39,860,954
<b>Fluksi monetar nga veprimtaritë e shfrytëzimit</b>		<b>16,439,555</b>
Tatim fitimi i paguar		(30,000)
<b>Fluksi monetar neto nga veprimtaritë e shfrytëzimit</b>		<b>16,409,555</b>
<b>Fluksi monetar nga veprimtaritë e investimit</b>		
Blerja e aktiveve afatgjata materiale dhe jo materiale	8	(102,854,719)
<b>Fluksi monetar neto nga veprimtaritë e investimit</b>		<b>(102,854,719)</b>
<b>Fluksi monetar nga veprimtaritë e financimit</b>		
Hyrje nga emetimi i kapitalit aksionar		1,000,000
Hyrje nga huamarrjet	9	86,060,000
<b>Fluksi neto monetar nga veprimtaritë e financimit</b>		<b>87,060,000</b>
Rritja/(zvogëlimi) neto i mjeteve monetare		614,835
Mjetet monetare në fillim të periudhës	4	-
<b>Mjetet monetare në fund të periudhës</b>	4	<b>614,835</b>

Pasqyra e flukseve të parasë duhet të lexohet së bashku me shënimet shpjeguese në faqet 7-17, të cilat janë pjesë përbërëse e pasqyrave financiare.

**ECO RECYCLING SH.P.K.**  
**SHËNIME SHPJEGUESE TË PASQYRAVE FINANCIARE**  
**PËR PERIUDHËN NGA DATA 20 KORRIK 2017 (DATA E KRIJIMIT) DERI MË 31 DHJETOR 2017**

---

(të gjitha vlerat janë të shprehura në Lekë, nëse nuk është shprehur ndryshe)

## **1 INFORMACION I PËRGJITHSHËM**

Shoqëria me përgjegjësi të kufizuar Eco Recycling Sh.p.k. ("Shoqëria") është regjistruar pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit në datën 20 korrik 2017 me numër identifikimi NUIS L71920025R. Selia e regjistruar e Shoqërisë është në adresën Rruga "Murat Toptani", Gjergji Center, Kati i 7.

Aktiviteti kryesor i Shoqërisë është mbledhja, seleksionimi, përpunimi dhe tregtimi i mbetjeve urbane dhe i mbetjeve të të gjitha llojeve dhe kategorive. Ofrimin e shërbimeve për entet publike dhe private lidhur me administrimin e impianteve të seleksionimit, shkrirjes, trajtimit dhe magazinimit të mbetjeve.

## **2 BAZAT E PËRGATITJES SË PASQYRAVE FINANCIARE**

### **2.1 Deklarata e përputhshmërisë**

Pasqyrat Financiare janë përgatitur në përputhje me Standardet Kombëtare të Kontabilitetit (SKK).

Bazuar në SKK 11 "Tatimi mbi Fitimin", paragrafi 4, Shoqëria ka zgjedhur të mos kontabilizojë tatimet e shtyra në pasqyrat financiare.

### **2.2 Bazat e matjes**

Pasqyrat Financiare janë përgatitur duke u bazuar në koston historike, përveç rasteve nëse specifikohet ndryshe.

### **2.3 Monedha funksionale dhe e paraqitjes**

Pasqyrat financiare janë pasqyruar në Lekë e cila është monedha funksionale e Shoqërisë. Shifrat janë të rumbullakosura në Lekë.

### **2.4 Përdorimi i gjykimeve dhe vlerësimeve**

Paraqitja e Pasqyrave Financiare në përputhje me SKK, kërkon që menaxhimi të bëjë vlerësime, gjykime e supozime që ndikojnë në aplikimin e politikave kontabël dhe vlerën e raportuar të aktiveve, detyrimeve, të ardhurave e shpenzimeve. Vlerësimet dhe supozimet bazohen në eksperiencën historike dhe faktorë të tjerë të ndryshëm në varësi të rrethanave. Rezultatet aktuale mund të ndryshojnë nga këto vlerësime.

Vlerësimet dhe supozimet rishikohen vazhdimisht. Rishikimet e vlerësimeve kontabël njihen në periudhën kur ndodh rishikimi si dhe në çdo periudhë të ardhme që preket.

Në veçanti, informacionet mbi fushat më të rëndësishme të vlerësimeve dhe gjykimeve në aplikimin e politikave kontabël të cilat kanë efektet më të rëndësishme në shumat e njohura në pasqyrat financiare, janë përshkruar në shënimet përkatëse të pasqyrave financiare.

### **2.5 Periudhat krahasuese**

Të dhënat e periudhave të mëparshme mund të ri klasifikohen për t'i bërë ato të krahasueshme me paraqitjen e të dhënave të periudhës ushtrimore.

**ECO RECYCLING SH.P.K.**  
**SHËNIME SHPJEGUESE TË PASQYRAVE FINANCIARE**  
**PËR PERIUDHËN NGA DATA 20 KORRIK 2017 (DATA E KRIJIMIT) DERI MË 31 DHJETOR 2017**

(të gjitha vlerat janë të shprehura në Lekë, nëse nuk është shprehur ndryshe)

### **3 PËRMBLEDHJE E POLITIKAVE KONTABËL**

Politikat kontabël ne vijim janë aplikuar në mënyrë të qëndrueshme në të gjitha periudhat e paraqitura në pasqyrat financiare, me përjashtim të rasteve kur specifikohet ndryshe nëse ka të tilla.

#### **3.1 Transaksionet në monedha të huaja**

Transaksionet në monedhe të huaj regjistrohen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit në datën e transaksionit. Mjetet monetare në monedhe të huaj rivlerësohen në fund të çdo periudhe raportuese me kursin zyrtar të këmbimit në datën e raportimit.

Mjetet jo-monetare në monedhe të huaj regjistrohen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit të datës së kryerjes së transaksionit, ndërsa mjetet jo-monetare që maten me vlerë të drejte rivlerësohen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit në datën kur përcaktohet vlera e drejte.

Fitimi ose humbja që rezultojnë nga kursi i këmbimit kalojnë në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

Kurset e këmbimit të përdorura për konvertim në 31 Dhjetor 2017 dhe 2016 janë si me poshtë:

	<b>31 Dhjetor 2017</b>	<b>31 Dhjetor 2016</b>
EURO	132.95	135.23

#### **3.2 Instrumentet financiare**

Instrumentet financiare jo-derivative përbehen nga llogari të arkëtueshme, mjete monetare, hua të marra dhe të dhëna dhe llogari të pagueshme. Instrumentet financiare jo-derivative njihen fillimisht me vlerën e drejte plus çdo kosto transaksioni që lidhet me to, përveç siç përshkruhet më poshtë. Për instrumentet e mbajtur me vlerë të drejte nëpërmjet fitim/humbje, kostot e transaksionit kalojnë në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve. Në vijim të njohjes fillestare instrumentet financiare jo-derivative maten siç përshkruhet më poshtë. Një instrument financiar njihet nëse Shoqëria bëhet pale në kushtet kontraktuale të instrumentit.

Aktivitetet financiare çregjistrohen kur skadojnë të drejtat kontraktuale të shoqërisë mbi flukset e parasë së aktivitetit financiar ose kur shoqëria transferon aktivitetin financiar tek një pale e tjetër pa mbajtur kontrollin ose gjithë rreziqet dhe përfitimet thelbësore të aktivitetit. Blerjet dhe shitjet normale të aktiveve financiare kontabilizohen në datën e transaksionit, që është data në të cilën shoqëria angazhohet të blejë apo të shesë aktivitetin. Detyrimet financiare çregjistrohen nëse detyrimet kontraktuale të shoqërisë skadojnë, shfuqizohen ose anulohen.

#### **Mjetet monetare dhe të tjera ekuivalente**

Mjetet monetare përfshijnë arkën, llogarite rrjedhëse, si dhe depozitat afatshkurtra me një maturitet deri në tre muaj.

#### **Llogarite e arkëtueshme**

Llogarite e arkëtueshme dhe llogarite të tjera të arkëtueshme njihen fillimisht me vlerën e drejte dhe me pas me kosto të amortizuar duke zbritur humbjet nga zhvlerësimi. Provigjioni për zhvlerësimin e aktiveve të arkëtueshme llogaritet kur ka të dhëna se shoqëria nuk do të jete në gjendje të mbledhë të gjitha detyrimet. Vështirësitë financiare të debitorit, mundësia që debitori të falimentojë ose riorganizimi i tij financiar konsiderohen tregues që llogarite e arkëtueshme të zhvlerësohen.

Shuma e provigjionit llogaritet si diferencë midis vlerës së mbetur dhe vlerës aktuale të flukseve të ardhshme të parashikuara të parasë të skontuara me normën efektive të interesit.

#### **Llogarite e pagueshme**

Llogarite e pagueshme paraqiten me vlerën e tyre të drejte dhe në vijim maten me kosto të amortizuar duke përdorur metodën e interesit efektiv.

**ECO RECYCLING SH.P.K.**  
**SHËNIME SHPJEGUESE TË PASQYRAVE FINANCIARE**  
**PËR PERIUDHËN NGA DATA 20 KORRIK 2017 (DATA E KRIJIMIT) DERI MË 31 DHJETOR 2017**

(të gjitha vlerat janë të shprehura në Lekë, nëse nuk është shprehur ndryshe)

**Huamarrjet dhe parapaqimet**

Huat e marra nga Institucionet Financiare njihen fillimisht me vlerën e drejte, duke zbritur koston e transaksionit. Detyrimet financiare maten me pas me koston e amortizuar duke përdorur metodën e interesit efektiv, duke njohur shpenzimin e interesit mbi bazën e interesit efektiv.

Metoda e normës efektive të interesit është një metode për llogaritjen e koston se amortizuar të një detyrimi financiar dhe për alokimin e shpenzimeve të interesit përgjatë periudhës. Norma efektive e interesit është norma e cila skanton saktësisht pagesat e ardhshme të vlerësuar përgjatë jetës së pritshme të detyrimit financiar, ose, ku është e përshtatshme, për një periudhe me të shkurtër.

**Te tjera**

Instrumente të tjera financiare jo derivative janë matur me koston e amortizueseje, duke përdorur metodën e normës së interesit efektiv, duke zbritur humbjet nga zhvlerësimet.

Kapitali aksionar njihet me vlerën nominale. Aksionet e zakonshme janë klasifikuar si kapital.

**3.3 Aktivët afatgjatë materiale**

**i. Njohja dhe matja**

Aktivët afatgjatë materiale maten me kosto, duke zbritur amortizimin e akumuluar dhe humbjet e akumuluar nga zhvlerësimi.

Kostoja përfshin shpenzimet të cilat lidhen drejtpërdrejt me blerjen e aktivitetit. Kostoja e aktiveve të ndërtuara nga vete shoqëria përfshin koston e materialeve dhe punës direkte dhe çdo kosto tjetër të lidhur drejtpërdrejt me sjelljen e aktivitetit në gjendje pune për qëllimin e synuar të përdorimit, si dhe koston e çmontimit, heqjes së pjesëve dhe sjelljes në gjendje të mëparshme të vendndodhjes së aktivitetit. Shpenzimet kapitale të bëra gjatë ndërtimit kapitalizohen në "Ndërtim në proces" dhe transferohen në kategorinë përkatëse të aktivitetit kur përfundon ndërtimi tij, nga kur aplikohet amortizimi përkatës sipas kategorisë. Në rastet kur pjesë të një aktiviteti afatgjatë material kanë jetëgjatësi të ndryshme, ato regjistrohen si zëra të ndryshëm të ndara nga njëra tjetra.

Fitimet ose humbjet nga shitjet apo nxjerrjet jashtë përdorimit të aktiveve afatgjatë materiale përcaktohen duke krahasuar të ardhurën nga shitja me vlerën kontabël neto të aktivitetit afatgjatë material mbetur dhe njihen në të ardhura ose humbje të tjera.

**ii. Kostot e mëpasshme**

Kostoja e zëvendësimit të një pjesë të një zëri të aktiveve afatgjatë materiale njihet në vlerën kontabël të atij zëri nëse është e mundur që shoqëria do të realizojë përfitime të ardhshme ekonomike nga përdorimi i pjesës zëvendësuese dhe kostoja e pjesës mund të matet në mënyrë të besueshme. Kostot e shërbimeve të zakonshme të aktiveve afat-gjata materiale njihen si shpenzim kur ato ndodhin.

**iii. Amortizimi**

Amortizimi i aktiveve llogaritet duke përdorur metodën lineare apo zbritëse të amortizimit, mbi jetën e vlerësuar të çdo pjesë të aktivitetit afatgjatë material duke filluar nga dita e parë e muajit që pason muajin e blerjes. Aktivët e marra me qira financiare amortizohen duke marrë për bazë periudhën më të shkurtër midis periudhës së qirasë dhe jetës së dobishme të aktivitetit. Toka dhe aktivët në proces nuk amortizohen. Metodatat dhe normat e amortizimit për periudhën aktuale dhe të mëparshme janë si me poshtë:

Ndërtesa	5%	(mbi vlerën e mbetur)
Makineri dhe pajisje	20%	(mbi vlerën e mbetur)
Mjete transporti	20%	(mbi vlerën e mbetur)
Pajisje kompjuterike	25%	(mbi vlerën e mbetur)
Pajisje zyre dhe të tjera	20%	(mbi vlerën e mbetur)

Metoda e amortizimit, jeta e dobishme dhe vlera e mbetur rishikohen në çdo datë raportimi.

### **3.4 Inventarët**

Inventarët maten fillimisht me kosto. Kostoja e inventarit përfshin, përveç çmimit të blerjes, edhe të gjitha kostot e tjera që nevojiten për të sjellë inventarin në gjendjen dhe vendndodhjen ekzistuese.

Pas njohjes fillestare inventarët vlerësohen me vlerën më të vogël ndërmjet koston dhe vlerës neto të realizueshme. Kostoja e inventarit përcaktohet sipas metodës së mesatares së ponderuar. Vlera neto e realizueshme është çmimi i shitjes i vlerësuar në rrjedhën normale të biznesit, minus kostot e vlerësuara të nevojshme për të kryer shitjen, sipas metodës së koston mesatare të ponderuar.

### **3.5 Zhvlerësimi**

#### **i. Aktivët financiarë**

Një aktiv financiar që nuk mbahet me vlerën e drejtë, vlerësohet në çdo datë raportimi për të përcaktuar nëse ka ndonjë të dhënë që ka pësuar rënie në vlerë. Një aktiv financiar konsiderohet i zhvlerësuar nëse ka të dhëna objektive që tregojnë se një apo disa ngjarje kanë efekte negative në flukset e ardhshme që parashikohet të burojnë nga aktivi dhe të cilat mund të maten me besueshmëri.

Një zhvlerësim në lidhje me aktivin financiar, të matur me kosto të amortizuar, llogaritet si diferencë midis vlerës së mbetur dhe vlerës aktuale të flukseve të ardhshme të parashikuara të parasë të aktualizuara me normën efektive të interesit. Aktivët financiarë të rëndësishme testohen për zhvlerësim në mënyrë individuale, ndërsa aktivët e tjera financiarë vlerësohen në mënyrë të grupuar, në grupe që kanë karakteristika të ngjashme. Të gjitha humbjet nga zhvlerësimi njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

#### **ii. Aktivët jo financiarë**

Vlera e mbetur e aktiveve jo financiarë të shoqërisë rishikohet në çdo datë raportimi për të përcaktuar nëse ka ndonjë të dhënë që ka pësuar rënie në vlerë. Nëse ka të dhëna të tilla, atëherë vlerësohet vlera e rikuperueshme e aktivitetit. Vlera e rikuperueshme është vlera më e madhe midis vlerës së drejtë minus kostot e shitjes dhe vlerës në përdorim. Një humbje nga zhvlerësimi njihet nëse vlera e mbetur e një aktivi tejkalon vlerën e tij të rikuperueshme. Humbjet nga zhvlerësimi njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

### **3.6 Përfitimet e punonjësve**

Gjatë ecurisë normale të aktivitetit të saj, shoqëria paguan kontributet shoqërore dhe shëndetësore në emër të vet dhe të punonjësve të saj, të cilat janë të detyrueshme sipas legjislacionit Shqiptar në fuqi. Këto kosto të kryera në emër të shoqërisë, janë të paraqitura në pasqyrën përmbledhëse të të ardhurave dhe shpenzimeve në momentin e ndodhjes.

### **3.7 Provigjonet**

Një provigjon njihet kur, si pasojë e ngjarjeve të kaluara, shoqëria ka detyrime aktuale ligjore apo konstruktive të cilat mund të vlerësohen në mënyrë të besueshme, dhe është e mundur që të nevojiten flukse dalëse të burimeve ekonomike për të shlyer këto detyrime. Provigjonet përcaktohen nga aktualizimi i flukseve të pritshme me një normë para tatimit që reflekton vlerësimet aktuale të tregut të parasë dhe rrezikut specifik të detyrimeve.

### **3.8 Njohja e të ardhurave**

Të ardhurat njihen atëherë kur është e mundur që shoqëria do të ketë përfitime ekonomike në të ardhmen dhe këto përfitime mund të maten me besueshmëri. Të ardhurat vlerësohen me vlerën e drejtë të arkëtuar ose të arkëtueshme, duke marrë parasysh shumën e çfarëdo zbritje tregtare, për shlyerje të menjëhershme etj.

Të ardhurat dhe shpenzimet njihen në pasqyrat financiare të periudhës të cilës i përkasin. Në lidhje me shitjen e mallrave, të ardhurat njihen kur ndryshimi i pronësisë së bashku me rrezikun që vjen nga ky ndryshim, janë transferuar tek blerësi. Të ardhurat nga shërbimet njihen kur shërbimi është kryer, në varësi të fazës së përfundimit të transaksionit në datën e raportimit. Asnjë e ardhur nuk njihet nëse ka pasiguri të lartë lidhur me kryerjen e pagesës dhe kostove përkatëse.

**ECO RECYCLING SH.P.K.**  
**SHËNIME SHPJEGUESE TË PASQYRAVE FINANCIARE**  
**PËR PERIUDHËN NGA DATA 20 KORRIK 2017 (DATA E KRIJIMIT) DERI MË 31 DHJETOR 2017**  
(të gjitha vlerat janë të shprehura në Lekë, nëse nuk është shprehur ndryshe)

**3.9 Te ardhurat dhe shpenzimet financiare**

Te ardhurat financiare përfshijnë te ardhurat nga interesat për llogarite bankare, dhe përfitimet nga diferencat e këmbimit. Interesat njihen ashtu siç përlogariten duke përdorur metodën e interesit efektiv.

Shpenzimet financiare përfshijnë shpenzimet për interesa dhe humbjet nga luhatjet e kurseve të këmbimit, ndryshimet në vlerën e drejte të aktiveve financiare të mbajtura me vlerë të drejte nëpërmjet pasqyrës së te ardhurave dhe shpenzimeve, dhe humbjet nga zhvlerësimi i aktiveve financiare.

Kostot e huamarrjes njihen në pasqyrën e te ardhurave dhe shpenzimeve me metodën e interesit efektiv. Fitimet dhe humbjet nga kurset e këmbimit raportohen në baza neto.

**3.10 Tatimi mbi fitimin**

Shpenzimi i tatimit mbi fitimin përfshin tatimin e periudhës, i cili njihet drejtpërdrejt në pasqyrën e te ardhurave dhe shpenzimeve. Tatimi i periudhës është tatimi i pritshëm për t'u paguar mbi te ardhurat e tatueshme të vitit, duke përdorur normat tatimore të miratuara në periudhën e raportimit.

**3.11 Ngjarjet pas datës së bilancit**

Ngjarjet pas datës së raportimit, të cilat ofrojnë dëshmi për kushtet që ekzistojnë në datën e raportimit, trajtohen si ngjarje të korigjueshme në këto pasqyra financiare. Ato që janë tregues të kushteve që lindin pas datës së raportimit janë trajtuar si ngjarje të pakorigjueshme.

**4 MJETET MONETARE**

Gjendja e mjeteve monetare në arke dhe banke në fund të vitit ushtrimor paraqitet si më poshtë:

	<u>31 Dhjetor 2017</u>
<b>Llogari rrjedhëse</b>	<b>570,199</b>
- në Lekë	549,326
- në monedhë të huaj	20,873
<b>Arka</b>	<b>44,636</b>
- në Lekë	44,636
- në monedhë të huaj	-
<b>Totali</b>	<b>614,835</b>

**5 LLOGARI TË ARKËTUESHME**

Llogarite e arkëtueshme përbehen si më poshtë:

	<u>31 Dhjetor 2017</u>
Klientë	3,569,026
Klientë - palë të lidhura	2,970,420
<b>Totali</b>	<b>6,539,446</b>

ECO RECYCLING SH.P.K.  
 SHËNIME SHPJEGUESE TË PASQYRAVE FINANCIARE  
 PËR PERIUDHËN NGA DATA 20 KORRIK 2017 (DATA E KRIJIMIT) DERI MË 31 DHJETOR 2017

(të gjitha vlerat janë të shprehura në Lekë, nëse nuk është shprehur ndryshe)

**6 LLOGARI TË TJERA TË ARKËTUESHME**

Llogaritë e tjera të arkëtueshme përbehen nga tatimi mbi vlerën e shtuar dhe shpenzime të parapaguara si më poshtë:

	<u>31 Dhjetor 2017</u>
Tatimi mbi vlerën e shtuar	19,175,814
Shpenzime të shtyra	5,000
<b>Totali</b>	<u><b>19,180,814</b></u>

**7 INVENTARI**

Inventari paraqitet si më poshtë:

	<u>31 Dhjetor 2017</u>
Materiale të seleksionuara	2,038,494
Karburant	121,136
Vaj motori	8,833
<b>Totali</b>	<u><b>2,168,463</b></u>

**8 AKTIVET AFATGJATA MATERIALE**

	Ndërtesa dhe ndërtime	Instalime teknike, makineri, pajisje	Mjete Transporti	Të tjera	Totali
<b>Kosto</b>					
Gjendje më 20.07.2017 (data e krijimit)	-	-	-	-	-
Shtesa	53,432,000	36,114,805	12,998,000	309,914	<b>102,854,719</b>
Pakësime					-
Gjendje më 31.12.2017	<b>53,432,000</b>	<b>36,114,805</b>	<b>12,998,000</b>	<b>309,914</b>	<b>102,854,719</b>
<b>Amortizimi</b>					
Gjendje më 20.07.2017 (data e krijimit)	-	-	-	-	-
Shtesa	667,900	1,203,827	433,267	15,269	<b>2,320,262</b>
Pakësime					-
Gjendje më 31.12.2017	<b>667,900</b>	<b>1,203,827</b>	<b>433,267</b>	<b>15,269</b>	<b>2,320,262</b>
<b>Vlera e mbetur neto</b>					
Gjendje më 20.07.2017 (data e krijimit)	-	-	-	-	-
Gjendja më 31.12.2017	<b>52,764,100</b>	<b>34,910,978</b>	<b>12,564,733</b>	<b>294,646</b>	<b>100,534,457</b>

**ECO RECYCLING SH.P.K.**  
**SHËNIME SHPJEGUESE TË PASQYRAVE FINANCIARE**  
**PËR PERIUDHËN NGA DATA 20 KORRIK 2017 (DATA E KRIJIMIT) DERI MË 31 DHJETOR 2017**  
 (të gjitha vlerat janë të shprehura në Lekë, nëse nuk është shprehur ndryshe)

**9 HUAMARRJET**

Huamarrjet më 31 dhjetor 2017 përbëhen nga huamarrjet afatgjata si më poshtë:

	<u>31 Dhjetor 2017</u>
Hua nga palë të lidhura	69,643,450
<b>Totali</b>	<u><b>69,643,450</b></u>

Gjatë vitit 2017 Shoqëria u financua me hua nga ortakët për blerjen e makinerive dhe pajisjeve. Vlera totale e financimit është deri në 94,000,000 Lekë dhe gjatë vitit 2017 janë disbursuar 69,643,450 Lekë. Huaja ka një normë interesi 5.5% dhe afat maturimi 60 muaj. Për detaje të tjera referojuni shënimit shpjegues nr. 20 – Transaksione me Palët e Lidhura.

**10 LLOGARI TË PAGUESHME**

Llogarite e pagueshme paraqiten si më poshtë:

	<u>31 Dhjetor 2017</u>
Furnitorë	926,059
Furnitorë - palë të lidhura	37,396,289
Klientë me tepricë kreditore	195,840
<b>Totali</b>	<u><b>38,518,188</b></u>

**11 DETYRIME TATIMORE**

Detyrimet tatimore në datën e raportimit përbehen nga:

	<u>31 Dhjetor 2017</u>
Kontribute dhe tatime mbi të ardhurat personale	316,502
Tatimi mbi fitimin	301,945
<b>Totali</b>	<u><b>618,447</b></u>

**12 DETYRIME TE TJERA AFATSHKURTRA**

Detyrimet e tjera afatshkurtra përbehen si vijon:

	<u>31 Dhjetor 2017</u>
Interesa pasive të llogaritura - palë të lidhura	1,395,931
Detyrime ndaj personelit	1,016,264
Detyrime të tjera afatshkurtra - pale të lidhura	10,000
<b>Totali</b>	<u><b>2,422,195</b></u>

**ECO RECYCLING SH.P.K.**  
**SHËNIME SHPJEGUESE TË PASQYRAVE FINANCIARE**  
**PËR PERIUDHËN NGA DATA 20 KORRIK 2017 (DATA E KRIJIMIT) DERI MË 31 DHJETOR 2017**  
 (të gjitha vlerat janë të shprehura në Lekë, nëse nuk është shprehur ndryshe)

**13 KAPITALI AKSIONAR**

Kapitali i nënshkruar i Shoqërisë është 3,900,000 Lekë. Struktura a ortakeve është si më poshtë:

	<b>31 Dhjetor 2017</b>	
Eco Tirana Sh.a.	51%	510,000
Meg. Albania Sh.p.k.	49%	490,000
<b>Totali</b>	<b>100%</b>	<b>1,000,000</b>

**14 SHITJET NETO**

Për periudhën nga data  
20 korrik 2017 (data e krijimit)  
deri më 31 dhjetor 2017

Të ardhura nga shitja e produkteve	7,303,973
Të ardhura nga shërbimet	4,127,390
<b>Totali</b>	<b>11,431,363</b>

**15 MATERIALE TË KONSUMUARA**

Materialet e konsumuara përfshijnë zërat e mëposhtëm:

Për periudhën nga data  
20 korrik 2017 (data e krijimit)  
deri më 31 dhjetor 2017

Karburant	2,845,212
Energji elektrike dhe ujë	182,385
Shpenzime të tjera materiale	2,296,096
<b>Totali</b>	<b>2,845,212</b>

**16 KOSTO E PUNËS**

Kosto e punës përbehen nga pagat bruto te punonjësve dhe kostot e sigurimeve shoqërore qe paguan shoqëria si më poshtë:

Për periudhën nga data  
20 korrik 2017 (data e krijimit)  
deri më 31 dhjetor 2017

Shpenzime për paga	3,319,511
Kontributet e sigurimeve	539,518
<b>Totali</b>	<b>3,859,029</b>

ECO RECYCLING SH.P.K.  
 SHËNIME SHPJEGUESE TË PASQYRAVE FINANCIARE  
 PËR PERIUDHËN NGA DATA 20 KORRIK 2017 (DATA E KRIJIMIT) DERI MË 31 DHJETOR 2017

(të gjitha vlerat janë të shprehura në Lekë, nëse nuk është shprehur ndryshe)

**17 SHPENZIME TË TJERA**

Shpenzimet e tjera përbëhen si më poshtë:

	<u>Për periudhën nga data</u> <u>20 korrik 2017 (data e krijimit)</u> <u>deri më 31 dhjetor 2017</u>
Shpenzime interesi nga shoqëri të lidhura	33,067
<b>Totali</b>	<b>1,308,249</b>

**18 SHPENZIME PËR INTERESA**

Shpenzimet për interesa deri më 31 dhjetor 2017 përbëhen nga zërat e mëposhtëm:

	<u>Për periudhën nga data</u> <u>20 korrik 2017 (data e krijimit)</u> <u>deri më 31 dhjetor 2017</u>
Shpenzime interesi nga shoqëri të lidhura	1,395,931
<b>Totali</b>	<b>1,395,931</b>

**19 SHPENZIMI I TATIMIT MBI FITIMIN**

Bazuar ne legjislacionin Shqiptar, norma e tatimit mbi fitimin për vitin 2017 është 15% (2016: 15%).

Deklaratat tatimore të tatimit mbi të ardhurat paraqiten çdo vit pranë autoriteteve tatimore, por të ardhurat dhe shpenzimet e deklaruar konsiderohen vetë-deklarime deri në momentin që autoritetet tatimore shqyrtojnë regjistrimet dhe deklaratat e tatimpaguesit dhe lëshojnë vlerësimin final. Legjislacioni tatimor dhe ligjet Shqiptare janë subjekt interpretimi nga autoritetet tatimore.

Shpenzimi i tatimit mbi fitimin më 31 dhjetor 2017 përbëhet nga sa më poshtë:

	<u>Për periudhën nga data</u> <u>20 korrik 2017 (data e krijimit)</u> <u>deri më 31 dhjetor 2017</u>
Fitimi para tatimit	751,132
Shpenzime të panjohura	1,461,837
Fitimi i tatueshëm	<b>2,212,969</b>
Përqindja e tatimit mbi fitimin	15%
<b>Tatimi mbi fitimin</b>	<b>331,945</b>
<b>Fitimi (humbja) neto e vitit financiar</b>	<b>419,187</b>

ECO RECYCLING SH.P.K.  
 SHËNIME SHPJEGUESE TË PASQYRAVE FINANCIARE  
 PËR PERIUDHËN NGA DATA 20 KORRIK 2017 (DATA E KRIJIMIT) DERI MË 31 DHJETOR 2017

(të gjitha vlerat janë të shprehura në Lekë, nëse nuk është shprehur ndryshe)

**20 PALËT E LIDHURA**

Një numër transaksionesh mund të kryhen me palët e lidhura në rrjedhën normale të biznesit. Këto transaksione janë kryer në terma tregtare dhe në normat e tregut.

Gjendjet dhe transaksionet me palët e lidhura paraqiten si më poshtë:

<u>Gjendjet me palët e lidhura</u>	<u>31 Dhjetor 2017</u>
<b>Llogari të arkëtueshme</b>	
Eco Tirana Sh.a.	2,970,420
<b>Total llogari të arkëtueshme</b>	<u>2,970,420</u>
<b>Llogari të pagueshme</b>	
Eco Tirana Sh.a.	499,761
Meg Albania Sh.p.k.	36,896,528
<b>Total llogari të pagueshme</b>	<u>37,396,289</u>
<b>Detyrime të tjera afatshkurtra</b>	
Eco Tirana Sh.a.	688,264
Meg Albania Sh.p.k.	717,667
<b>Total detyrime të tjera afatshkurtra</b>	<u>1,405,931</u>
<b>Huamarrje afatgjata</b>	
Eco Tirana Sh.a.	40,000,000
Meg Albania Sh.p.k.	46,060,000
<b>Total Huamarrje afatgjata</b>	<u>86,060,000</u>
 <b><u>Transaksionet me palët e lidhura</u></b>	 <b><u>Për periudhën nga data</u></b>
	<b><u>20 korrik 2017 (data e krijimit)</u></b>
	<b><u>deri më 31 dhjetor 2017</u></b>
<b>Shitje</b>	
Eco Tirana Sh.a.	4,127,390
<b>Total të ardhura</b>	<u>4,127,390</u>
<b>Shpenzime për interesa</b>	
Eco Tirana Sh.a.	688,264
Meg Albania Sh.p.k.	707,667
<b>Total shpenzime për interesa</b>	<u>1,395,931</u>
<b>Blerje</b>	
Eco Tirana Sh.a.	2,116,468
Meg Albania Sh.p.k.	101,580,440
<b>Total blerje</b>	<u>103,696,908</u>

**ECO RECYCLING SH.P.K.**  
**SHËNIME SHPJEGUESE TË PASQYRAVE FINANCIARE**  
**PËR PERIUDHËN NGA DATA 20 KORRIK 2017 (DATA E KRIJIMIT) DERI MË 31 DHJETOR 2017**

(të gjitha vlerat janë të shprehura në Lekë, nëse nuk është shprehur ndryshe)

## **21 MENAXHIMI I RREZIKUT FINANCIAR**

Shoqëria është e ekspozuar ndaj rreziqeve të mëposhtme:

### **a) Rreziku i normës së interesit**

Rreziku i normave të interesit është rreziku që vlera e instrumenteve financiare do të luhet për shkak të ndryshimeve në normat e interesit të tregut dhe rreziku që maturitetet e detyrimeve me interes ndryshojnë nga maturitetet e detyrimeve me interes të cilat përdoren për të financuar këto aktive. Kohëzgjatja për të cilën është fiksuar norma e interesit mbi një instrument financiar tregon se ndaj çfarë niveli risku të normave të interesit është ekspozuar Shoqëria. Te gjitha aktivet dhe detyrimet e Shoqërisë janë me norma interesi të tregut.

### **b) Rreziku i kredisë**

Shoqëria nuk është e ekspozuar ndaj rrezikut të kredisë, që do të ndikonte në pozitën dhe performancën e saj financiare si me dhe për periudhën e mbyllur më 31 dhjetor 2017.

### **c) Rreziku i likuiditetit**

Rreziku i likuiditetit është rreziku që Shoqëria do të ndeshet me vështirësi në përmbushjen e detyrimeve të lidhura me detyrimet e saj financiare që shlyhen me anë të transferimit të mjeteve monetare ose aktiveve të tjera financiare. Shoqëria nuk ka një ekspozim të rëndësishëm ndaj rrezikut të likuiditetit. Detyrimet financiare përbehen nga llogarite e pagueshme tregtare gjate rrjedhës normale të biznesit, nga detyrime financiare afatgjata ndaj palëve të lidhura.

## **22 ANGAZHIME DHE DETYRIME TË KUSHTËZUARA**

Shoqëria nuk është subjekt i ndonjë çështje ligjore të ndërmarrë nga palë të treta kundër saj më 31 dhjetor 2017 që mund të sjellë humbje apo flukse të rëndësishme dalëse në të ardhmen.

## **23 NGJARJE PAS DATËS SË BILANCIT**

Më datë 13 shkurt 2018, shoqëria Meg Albania Sh.p.k. shiti kuotat e saj në shoqërinë Eco Recycling Sh.p.k. Ne bazë të kontratës së shitblerjes së kuotave dhe vendimit të asamblesë, Meg Albania Shpk i shet 49% të kuotave që zotëron shoqërisë Integrated Energy BV SPV Sh.p.k.

Nuk kanë ndodhur ngjarje të tjera të mëtejshme pas datës së raportimit që të kërkojnë ndryshime apo rregullime të mëtejshme të pasqyrave financiare.

SHOQERIA: ECO RECYCLINK SH.P.K.  
NIPT: L71920025R

**Aktivet Afatgjata Materiale me vlere fillestare 2017**

Nr	Emërtimi	Sasia	Gjendje	Shtesa	Pakësime	Gjendje
			01/01/2017			31/12/2017
1	Ndertesa dhe ndertime		-	53,432,000		53,432,000
2	Instalime, makineri		-	36,114,805		36,114,805
3	Mobilje dhe orendi		-	12,998,000		12,998,000
5	Te tjera		-	309,914		309,914
	<b>TOTALI</b>		-	<b>102,854,719</b>	-	<b>102,854,719</b>

**Amortizimi i Aktiveve Afatgjata Materiale 2017**

Nr	Emërtimi	Sasia	Gjendje	Shtesa	Pakësime	Gjendje
			01/01/2017			31/12/2017
1	Ndertesa dhe ndertime		-	667,900		667,900
2	Instalime, makineri		-	1,203,827		1,203,827
3	Mobilje dhe orendi		-	433,267		433,267
4	Te tjera		-	15,269		15,269
	<b>TOTALI</b>		-	<b>2,320,262</b>	-	<b>2,320,262</b>

**Vlera Kontabël Neto e Aktiveve Afatgjata Materiale 2017**

Nr	Emërtimi	Sasia	Gjendje	Shtesa	Pakësime	Gjendje
			01/01/2017			31/12/2017
1	Ndertesa dhe ndertime		53,432,000	667,900	52,764,100	53,432,000
2	Instalime, makineri		36,114,805	1,203,827	34,910,978	36,114,805
3	Mobilje dhe orendi		12,998,000	433,267	12,564,733	12,998,000
4	Te tjera		309,914	15,269	294,646	309,914
	<b>TOTALI</b>		<b>102,854,719</b>	<b>2,320,262</b>	<b>100,534,457</b>	<b>102,854,719</b>

Administratori

*Vladimir Fezgj*  
30



SHOQERIA: ECO RECYCLINK SH.P.K.  
NIPT: L71920025R

**Inventari Analitik**  
Viti 2017

Nr	Artikulli	Njësia	Sasia	Kosto	Vlera
1	Film	Kg	17,100	11.67	199,569
2	Karton	Kg	95,800	12.77	1,222,907
3	Letër	Kg	34,488	11.65	401,859
4	Kallçuk	Kg	10,400	11.04	114,828
5	HDPE	Kg	4,550	10.98	49,962
6	Kanaçe	Kg	3,740	13.20	49,369
7					
8					
9					
10					
	<b>TOTALI</b>		<b>166,078</b>	-	<b>2,038,494</b>

Administratori

*Vladimir Fejzo*





SHOQERIA: ECO RECYCLINK SH.P.K.  
NIPT: L71920025R

**Inventari i mjeteve të transportit në pronësi të subjektit**  
Viti 2017

Nr	Lloji i automjetit	Marka	Kapaciteti	Targa	Data e blerjes	Vlera
1	Skavator JCB 8080	JCB	1		03/10/2017	2,680,000
2	Skavator JCB 8060	JCB	1		03/10/2017	2,010,000
3	Robot JCB	JCB	1		03/10/2017	1,340,000
4	Pirun me pinca	Italcarrelli	1		03/10/2017	1,474,000
5	Kamion Iveco	Iveco	1		03/10/2017	2,546,000
6	Kamion Volvo F1250	Volvo	1	AA 687 TB	03/10/2017	2,948,000
7						
8						
9						
10						
	<b>TOTALI</b>					<b>12,998,000</b>

Administratori

*Redim...*  
  


**ECO RECYCLING**  
Sh.p.k.  
NIPT: L71920025 R  
Tiranë, Albania 3